

**ARNAVUTÇA ÖZETLEMELER/
ALBANIAN SUMMARIES / PËRMBAJTËT NË SHQIP**

Anila SHEHU POLAT*

Alevilik-Bektaşilik Araştırmaları Dergisi bu sayısında yer alan makale ve araştırma yazılarının Arnavut okuyucular için kısa bir özetlemesini yaparak, onların da dergimizin içeriği ile ilgili az da olsa bir bilgiye sahip olmasını, gerektiğinde geniş çeviriler yapmalarına zemin hazırlamak istedik. Bu sayımızdan itibaren Arnavutça özetleri ayrı bir sayfa halinde bu şekilde yayımlayacağız.

PËRMBAJTËT NË SHQIP

Për lexuesit shqipfolës të Revistës Studimore Alevizmi-Bektashizmi kemi përgatitur nga një përmbytje të shkurtër në Shqip për të gjitha shkrimet dhe studimet e përfshira në këtë numër, sepse mendojmë që në këtë mënyrë mund të krijojmë një ide sado të vogël përreth përmbytjes së kësaj reviste dhe kështu duam të krijojmë dhe ti hapim rrugë mundësisë që në rastet e nevojshme të bëhen më shumë përkthime. Duke filluar nga ky numër vazhdimisht do të botojmë përmbledhjet e shkrimeve në Shqip në një faqe më vete ashtu si dhe e kemi bërë në këtë numër.

* Aydın Üniversitesi, Didim Meslek Yüksekokulu Öğretmeni

PËRQASJET PËR DISKUTIMET NDAJ IDENTITETIT TË POPULLSISË ALEVIANE

(ALEVİ TOPLUMSAL KİMLİĞİ TARTIŞMALARI ÜZERİNE YAKLAŞIMLAR)

Doç. Dr. Ahmet BEŞE

Në ditët e sotme, studimet dhe diskutimet e bëra për kulturën dhe identitetin e popujve jo vetëm që tërheqin vëmendjen kombëtare por edhe atë ndërkombëtare sidomos atë të vendeve Perëndimore. Në rastin e studimeve të kulturës dhe të identitetit Alevian shpesh dalin në pah studimet akademike, studimet e vetë Alevive dhe studimet shtetërore. Në këtë artikull do të përqendohemi më shumë në kulturën dhe identitetin e popullsisë aleviane për periudhën kohore pas viteve 1980 deri në ditët e sotme dhe do të lukumtohen ndryshimet që kanë ndodhur në këtë periudhë si pasojë e shpërnguljeve në qytete, format e organizimit të tyre dhe mënyra dhe arsyeja se si bëhen organizimet në popullsinë Alevianë që banojnë në Evropë si dhe dryshimi i mënyrës së perceptimit të identitetit. Prandaj, tema kryesore të këtij shkrimi është ndryshimet që parashikohet të ndodhin në konceptualizmin e identitetit të përbashkët të popullsisë aleviane si pasojë e dryshimeve sociale dhe të kufinjve. Në këtë artikull gjithashtu do të meret në dorë organizimi (organizata, shoqata etj) i popullsisë aleviane që rrjedh si pasojë e ndryshimit të konceptimit të identitetit të popullsisë aleviane si dhe nga ndikimi i koncepteve si multikulturor, etnik, minoritet dhe miqësitë-hetero të cilat kanë dal në pah nga sistemi i koncepteve Perëndimore.

NOCIONI DHE POLITIKA E ISLAMIZIMIT TË NURSAYRIVE
(NUSAYRILER, İSLAMLAŞTIRMAK POLİTİKASI VE MEFHUMU)

Ali Zeynel GÖKPINAR

Tema e marrë në dorë në këtë artikull është bazuar mbi studimin e marrëdhënieve të Perandorisë Osmane dhe Republikës në lidhje me politikën e Islamizimit dhe Turqizimit. Ky studim mbështetet mbi dokumentat origjinalë që gjenden në arshiva si dhe burimet sekondare. Nga të cilat u konstatua se politika e Islamizimit të Nusayve dështoi dhe se duke filluar që nga shekulli i 16-të, Sultan Abdylhamidi i Dytë filloi të përmisojë marrëdhënjet e shtetit me këtë popullsi duke ndryshuar politikën për Islamizimin e Nusayve për arsye se popullsia Nusayve filloi të mos bindet dhe të qëndrojë larg drejtuesve që përfaqësonin perandorinë. Kurse për regjimin e Atatürkut (ose ndryshe Qemalistët) këmbëngulet se politikat e Turqizimit të Nusayve kanë qenë të suksesshme por pavarsisht nga suksesi i shtetit popullsia syni vazhdon të ketë paragjykimin negativ ndaj tyre dhe ky paragjykim rrjedh që nga koha e Perandorisë Osmane. Për sa i përket historisë së Nusayve në tërësi ajo ka lidhje të ngushtë me egoizmat gjeopolitike dhe modernizmin Turk. Qemalistët aritën ta kryejnë Turqizimin e tyre në sajë të politikave laike, edukimit, akademive dhe bashkëpunimit qeveritar. Në fakt çështja e Sanxhakut është një çështje kyçe që ka ndikuar formimin e kufijve të nacionalizmit Arab dhe identitetit të Nusayve duke i bërë këto kufij edhe kufi fizikë edhe kufij emocional. Për arsye se numri i popullsisë së Nusayve në Turqi është shumë i vogël dhe se në kohën e Osmallinjve kanë vuajtur shumë regjimi Qemalist e ka patur më të lehtë që të ndikonte zemrat dhe mendjet e tyre. Në ditët e sotme për arsye se fëmijët Nursay po asimilohen nga mënyra e edukimit që marrin në shkollë dhe se ato ndryshe nga prindërit e tyre nuk flasin dhe nuk mësojnë Arabisht mund të themi pa frikë se kjo popullsi po has me rrezikun ekzistencial dhe rrezikun e asimilimit.

SIMBOLET FETARE NË MUZIKËN TRADICIONALE TË ANKARASË
(ANKARA GELENEKSEL MÜZİK KÜLTÜRÜNE DİNİ SİMGELER)

Cenk GÜRÂY

Qyteti i Ankarasë ka një rëndësi të veçantë që rrjedhon si nga vjetërsia historike që ajo ka ashtu edhe nga shumëllojshmëria kulturore që ajo ushqen, përveç kësaj në kohën e republikës ajo u kthye në një qëndër të rëndësishme akumulimi dhe përfocimi i kësaj kulture. Që nga vitet 3000 Para erës sonë, Ankaraja është një vend i përfshirë nga kultura qytetare dhe si nga ana cilësore ashtu edhe nga sasia ka një kulturë tradicionale muzikore shumë të zhvilluar me anë të cilës del në pah e gjithë trashëgimia kulturore e këtij vendi. Si rrjedhojë e një paralelizmi që është shkaktuar nga kjo pasuri e madhe kulturore ka bërë që në kulturën muzikore të futen edhe simbole misticike. Veçanërisht në njëqindvjeçarën e fundit një numër i rëndësishëm i simboleve të misticizmit mysliman është futur në brendësinë e pasurisë muzikore të Ankarasë. Këto simbole u përkasin sekteve të ndryshme të islamizmit dhe veçanërisht atij Alevian, por nuk duhet haruar dhe efekti i kohërave para Islamizimit. Ndjekja e gjurmëve të këtyre simboleve që janë në këngët popullore të Ankarasë dhe studimi i tyre ndihmon në njohjen e preferencës së jetës sociale të periudhave të ndryshme të popullsisë së kryeqytetit. Qëllimi i këtij studimi është ndjekja dhe nxjerja në pah e simbolleve mistike që janë bërë pjesë e muzikës popullore të Ankarasë sidomos në njëqindvjeçarët e fundit dhe studimi i lidhjeve që kanë ato me jetën shoqërore të popullsisë së këtij rajoni. Kështu që duke kuptuar formën e jetës sociale që egzistonte në Ankara mund të bëjmë një parashikim më të saktë për mundësitë e ndryshimeve në të ardhme.

**RITJA E VËMENDJES SË BASHKIMIT EVROPIAN MBI PROBLEMET
E ALEVIVE DHE BEKTASHINJVE NJË TURQI NGA ASPEKTI I TË
DREJTAVE TË NJERIUT**

(AVRUPA BİRLİĞİ'NİN BİR İNSAN HAKLARI SORUNU OLARAK
TÜRKİYE'DEKİ ALEVİLERİN VE BEKTAŞILERİN SORUNLARINA ARTAN
İLGİSİ)

Haydar EFE

Bashkimi Evropian sidomos në ditët e sotme ka filluar ti japi një rëndësi të madhe të Drejtave të Njeriut dhe duke i cilësuar ato si universale po inkuarajon respektimin e tyre edhe për vendet që janë jashtë kufijve të sajë, e kjo vihet re sidomos në marrëdhënjet që krijohen me vendet kandidatë për t'u futur në BE. Respektimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të minoriteteve për shtetet anëtare në BE dhe shtetet kandidatë është e detyrueshme të bëhet sipas kriterëve të Kopenhagës. Prandaj dhe në BE i jepet shumë rëndësi lirisë së fesë pasi barazija dhe lirija fetare është një nga parimet themelore të sajë. Nga ana tjetër BE i nxit reformat për të lehtësuar pjesëmarrjen në të prandaj dhe Turqia luan një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në tetor të vitit 2005 Turqia ka fillur bisedimet për anëtarësim në BE. Prandaj dhe Bashkimi Evropian po e nxit Turqinë që të bëjë përparim për çështjet e lirisë së besimit fetar si dhe të risi përshtatjen për të drejtat e njeriut. Një nga kushtet që ka kërkuar nga Turqia për t'ia arritur qëllimin e anëtarësimit në të është plotësimi i lirisë së fesë duke tërhequr vëmendjen e problemeve që kanë popullsia alevine dhe bektashinjtë. Madje gjendjen e popullsisë aleviane vazhdimisht e nxjerin në pah duke treguar për vështirësitë që hasin ata brenda në BE, dhe se çdo vit gjendia e tyre shqyrtohet nga ana e Komisionit të Evropës. BE duke filluar nga viti 1998 i tërheq vëmendjen Turqisë për problemet që ka popullsia aleviane për kultet e faljes që quhen “Cemevi”, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Departamentit të Çështjeve Fetare si dhe për lëndën e detyrueshme e fesë që jepet në arsim.

**NJË VËSHTRIM I PËRGJËTHSHËM I NDJEKËSVE TË AHMET
EFENDIT NË KUADRIN E MARRËDHËNIEVE TË HALVETIVE DHE
ALEVIVE TË ANADOLLIT**

(HALVETILÏK VE ANADOLU ALEVILÏGI ILIÏKISI ÇERÇEVESINDE
AHMET EFENDI AHFADINA GENEL VÏR BAKIÏ)

Hulusi YILMAZ

Zinxhirët e tarikateve Halveti dhe Safevi bashkohen në mësimet Ibrahim Zahid Gilan dhe bazohen tek Shenjtor Aliu. Që të dy këto tarikate kanë në moton e tyre dashurinë për Ehl-i Bejtin. Perandorija Osman me qëllim që të zvogëlojë ndikimin e shtetit Safevi tek “kokëkuqit” (Alevitë) Turq ka terguar një interes të veçantë për Tarikatin Halveti. Prandaj dhe për këtë arsye tarikati i Halvetive është përpjekur që të sillen në formë të përshtatshme për synitë dhe të mundohet të fitojë zemrat e Kokëkuqëve.

Një nga anëtarët e tarikatit Halveti, Piri Ahmet Efendi deri më ditët e sotme konsiderohet si një nga njohësit më të nderuar të misticizmit qoftë për synitë ashtu edhe për alevitë. Nga ana tjetër po të shohim se nga kush ka marrë mësimet e misticizmit dhe se djali i tij është myfti atëherë pa frikë mund të themi që ai është anëtar i akideyt syni. Por prap se prapë në tyrben e Pirit Ahmet Efendi gjenden të shkruar emrat e Hz. Aliut dhe Haxhi Bektash Veliut dhe ka disa fshatra rrotull që janë me popullsi aleviane që kryejnë rrite në këtë vend dhe bëjnë ceremoni xhemi.

Si rrjedhojë mund të mendohet se Ahmet Efendi është futur në tarikatin Halveti për arsye politike dhe se e ka kryer me sukses detyrën e tij duke u shndruar në një nga shenjtorët e misticizmit.

**MBI SYTZËGAN – BABA SYRGIANNES – BABA SARUCA, SALTUK ET
TÛRKÏ OSE PËR NDRYSHE I NJOHUR ME EMRIN SARI SALTUK**

(SYTZËGAN – BABA SYRGIANNES – BABA SARUCA, SALTUK ET
TÛRKÏ YA DA NAM-I DIĐER SARI SALTUK HAKKINDA)

Vatan ÖZGÛL

Në themelin e studimeve për Sari Saltukun janë të dhënat e përfshira në veprat me tregime si Velajetnameja dhe Saltiknameja e Haxhi Bektash Veliut si dhe vepra Selçukname e Yazicizade Aliut por të cilat janë të dhëna të pakonfirmuara nga asnjë burim bashkëkohor. Ndërkohë duke u bazuar në veprat bashkohore të Sari Saltukut është e mundur të zbardhet identiteti i tij si një person i rëndësishëm në histori. Duke u përpjekur për ti lënë menjëanë paradikmat aktuale, në këtë shkrim jemi munduar të analizojmë identitetin historik të Sari Saltukut duke supozuar sikur nuk dimë asnjë gjë për këtë temë. Prandaj dhe kemi filluar studimin duke lexuar shkrimet e vjetra, pastaj i kemi krahasuar dhe plotësuar ato me studimet bashkohore. Si rrjedhojë mësuam që ndryshe nga ç'mendohej Sari Saltuku nuk është shenjtor me prejardhje nga Anadulli por ka mundësi që të ketë jetuar për disa kohë në Anadoll dhe preardhjen e ka nga një familje Turke në Kipchak dhe është nga Dubrovniku. Në kronikat Greke kemi hasur me temrin onomastikle, por më pas u konstatua që ky term s' ishte veçse një emër në Turqisht. Faktikisht në kronikat greke thuhet qartë që ky person është një Turk (kuman). Prandaj dhe emri është Turqisht. Në të njejtën kohë është qartësuar data e lindjes, vendi i lindjes data e ndimit të jetës dhe vendi ku ka ndëruar jetë Sari Saltuku. Gjithashtu është konstatuar se ndryshe nga ç'mendohej ai ishte një anëtar i tarikatit Karmati-Ismaili që është një degë e shkollës Batini Islami i meshrepit Alevian por është ndikuar edhe nga tarikatet Hajdari dhe Rufani.

KONFLIKTET MES SYNIVE DHE ALEVIVE NË KOHËN E PËRANDORISË SË SELXHUKUT TË MADH

(BÜYÜK SELÇUKLU DEVLETİ ZAMANINDA ALEVİ-SÜNNİ ÇATIŞMALARI)

Ergin AYAN

Pa dyshim që Alevizmi është një nga temat më të komplikuar të historisë së filozofisë Islame prandaj dhe duhet të studiohet më shumë nga të gjitha pikëpamjet. Historia e Alevizmit nuk duhet parë thjesht si një letërsi e besimeve fetare por edhe si një burim i rëndësishëm me të dhëna të rëndësishme që ndriçojnë historinë e Selxhukut të Madh. Kur studion historinë e Alevizmit një nga pikat që të tërheq më shumë vëmendjen është se konceptet e Alevizmit janë shumë të hershme dhe kanë burime që i përkasin një kohe më të hershme se të shekullit të 11-të. Nga ana tjetër është një tjetër pyetje që i duhet gjetur përgjigje; Si u përhap Alevizmi në kohën e Emevive dhe Abbasive në zonat e Irakut, Iranit Turkistanit, Azerbaxhanit dhe në brigjet e Kaspikut. Ç'ndjenin Alevitë pas kryengritjes së Abbazëve? Në të dhënat e historisë së Selxhukut të Madh dalin ca panorama shumë interesante. Si është përhapur Alevizmi tek Turqit dhe si është krijuar miti Alevian? Këto nuk janë pyetje të lehta. Për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve duhet që të mblidhen dhe shqyrtohen dokumentacionet që flasin për të shkuarën dhe është e detyruar që të bëhet një rishqyrtim objektiv dhe të komentohen përvojat aktuale të Alevive. Përgjigjja e këtyre pyetjeve në të njëjtën kohë do të japi të dhëna edhe mbi jetën sociale dhe sjelljet politike të njerëzve të asaj kohe. Në këtë artikull do të lukumtojmë jetën dhe klasat shoqërore që ishin nën sundimin e Perandorisë së Selxhukut të Madh, dhe se si i konsiderote ky shtet këto klasa, si dhe sjellja e masave sipas sekteve fetare. Ne, në këtë artikull do të studjomë se si janë sjellë e ç'farë ka menduar popullsia Aleviane që ka jetuar në kohën e Perandorisë së Selxhukut të Madh.

ÇFARË ËSHTË XHEMI NË ALEVIZËM DHE KONCEPTET NË XHEM (ALEVİLİKTE CEM VE CEMDEKİ KAVRAMLAR)

Hüseyin DEDEKARGINOĞLU

Në këtë artikull do të përpiqemi që të tregojmë për ritualin kryesor të alevive që është xhemi. Pak rëndësi ka se si e quajmë atë; nëse e quajmë “Xhemi i Bashkimit” ose “Xhemi i Abdal Musaut”. Ne po tregojmë për xhemin që përmban ritet si; djegia e pishtarit, përgatitja e kurbanit, dëgjimi i nefeseve (këngë fetare) të kënduara nga lutësit, njësimi i xhemit (para se të fillojë ceremonia e xhemit zgjidhen 5 motra që bëjnë faljen e parë bashkë me burrat dhe këtë e bëjnë në emër të të gjitha motrave), kërcimi i semasë, shpërndarjes së ujit, shpërndarjes së lokmave (kafshatave) si dhe rite të tjera si këto. Të shprehur ndryshe do të mundohemi të tregojmë se si kryhet dhe zhvillohet një ceremoni standarte e xhemit. Një pjesë e shkrimtarëve që kanë shkruar dhe botuar artikuj për alevizmin shpesh kanë përdorur fjalë fyese duke folur keq për besimin e tyre për ritet dhe kulturën e tyre, kurse një pjesë tjetër e këtyre shkrimtarëve pretendojnë se alevitë nuk kanë një gjuhë të tyre dhe nuk fjalë të pështatshme për ritet dhe konceptet e tyre prandaj dhe përpiqen ti shpjegojnë ato duke përdorur terminologjinë e sekteve të tjera si atë të Synnive, Shive apo edhe të të Krishterëve. Në këtë shkrim jemi përpjekur të shpjegojmë konceptet e xhemit ashtu siç përdoren në xhem.

**FIGURA E TURNËS DHE POEZIA “TREGIMI I TURNAVE PËR
VENDET E SHENJTA E ALEVIVE DHE BEKTASHIANËVE” E
NİZAM BOZKURT’UT “**

(NİZAM BOZKURT’UN TURNALAR DEYİŞİNDE ALEVİ BEKTAŞI
KUTSAL ZİYARET YERLERİ VE TURNA FİGÜRÜ)

Cansu AKYOL

Turna (një lloj shpendi, latinisht; Gruidae), është një simbol shumë i përdorur në kulturën Turke si rrjedhojë përdoret shumë edhe në këngët popullore, frazat, vjershat dhe poemat e popullit Turk. Prandaj për popullsinë Alevi-Bektashiane figura e Turnës ka një vend të veçantë. Ky shpend i quajtur Turna pranohet si përfaqësuesi i hyjnisë së qiellit, prandaj dhe krahasohet me përfaqësuesin e Hz.Aliut, kështu që mund të shpjegohet përse në disa veprime gjatë kërcimit në xhem ngjasojnë me fluturimin e Turnës i cili në të njejtën kohë është dhe një zog shtegtar që endet nëpër shumë vende të botës duke u bërë kështu dhe simboli i sjellësit dhe dërguesit të lajmeve nga njerëzit e emigruar në vise të largëta dhe shëruesi i shpirtitve të lodhur nga malli.

Në këtë shkrim është lukumtuar poezia me pesedhjetë strofa në të cilën flet për “Turnat” dhe se si Erenët lënë gjurmët e tyre në udhëtimet që i realizojnë me ndërmjetësinë e këtyre zogjve, në të njejtën kohë flet edhe për vendet e shenjta të kulturës Turke, Myslimane si dhe atë Aleviane. Tregon se ku ndodhen këto vende dhe për vlerat e tyre spirituale, bukuritë e tyre natyrore dhe vlerat historike që kanë.